

**INSTITUTI I KURRIKULAVE DHE I STANDARDEVE**

**PROGRAMI MËSIMOR PËR ARSIMIN FILLOR**

**LËNDA: Edukim Muzikor**

**(klasa e katërt)**

**VITI SHKOLLOR 2007-2008**

**Tiranë, 2006**

## 1. Të përgjithshme

Programi i edukimit muzikor për klasën e katërt të shkollës 9-vjeçare, zbulon dhe zhvillon më tej përvojën dhe talentin e nxënësve duke ndërthurur përvojën e tyre personale me njohuritë muzikore që do të merren përgjatë këtij programi. Ky program ndryshe nga programi i mëparshëm ka një formë dhe një strukturë më të qartë ku përfshihen rubrikat si: synimet e lëndët, linjat e programit, objektivat, njohuritë dhe aftësitë për çdo linjë, shpërndarjen e orëve, metodologjinë e programit dhe vlerësimin. Në këtë nivel, njohuritë muzikore janë të lidhura ngushtë dhe gjejnë zbatim në praktikën muzikore. Ato realizohen duke u ndërthurur përmes veprimtarive praktikë - artistike në klasë, shkollë ose auditorë të ndryshme. Ky program zhvillohet në 35 javë mësimore përgjatë gjithë vitit shkollor. Gjithashtu, ai jep mundësinë që në tema të veçanta muzika të integrohet edhe me lëndë të tjera meqë mësuesi është njohës i mirë i tërësisë së programit të klasës.

Ky program i përgatit nxënësit se edhe pse edukimi muzikor fushë artistike është e vetme në llojin e saj, gjenden pika komunikimi me artet e tjera (p.sh, ritmi është një element që gjendet në të gjitha fushat artistike në edukim muzikor, edukim figurativ, edukim fizik), ose me fusha të tjera të kurrikulës, nxënësit do të mësojnë të shikojnë lidhjet midis matematikës dhe muzikës, ose midis gjeometrisë dhe kompozimit të një pikturë.

## 2. Synimet e lëndës

Mësimi i muzikës në klasën e katërt të arsimit të detyruar 9-vjeçar, synon t'i aftësojë nxënësit për të përjetuar dhe për t'u shprehur nëpërmjet muzikës, duke shprehur nëpërmjet saj, botën e tyre emocionale. Nëpërmjet këtij programi synohet të kultivohen aftësitë dhe shprehitë për të kënduar, për të dëgjuar, për të luajtur, për të krijuar, si dhe për t'u shprehur duke vlerësuar muzikën.

Mësimi i edukimit muzikor ka si synim që nxënësit në fund të klasës së katërt të jenë të aftë:

- Të këndojnë "Himnin e Flamurit";
- Të këndojnë këngë të thjeshta për fëmijë, me tematikë të larmishme;
- Të këndojnë në intonacion dhe emocion;
- Të shoqërojnë këngët apo lojërat muzikore me instrumente të thjeshta ritmike ose melodike, si: shkopinj, ORF etj.;
- Të zhvillojnë elemente dhe koncepte muzikore, nëpërmjet shembujve të thjeshtë muzikorë që këndojnë ose dëgjojnë;
- Të ndërtojnë ritme të thjeshta në kohët 2/4, 3/4, 4/4;
- Të aftësohen për të dëgjuar pjesë muzikore për fëmijë, vokale dhe instrumentale;
- Të përjetojnë muzikën, duke u shprehur dhe duke përdorur një gjuhë të thjeshtë muzikore për këtë nivel.

## 3. Linjat e programit

Ky program është i organizuar në 5 linjat e mëposhtme:

1. Këndimi,
2. Bazat e arsimit muzikor,
3. Luajtja në instrument,

- 4. Dëgjim muzikor,
- 5. Shprehje dhe krijim muzikor

#### 4. Objektivat, njohuritë dhe aftësitë kryesore sipas linjave

##### **LINJA I. Këndim**

Në këtë linjë të mësohen 8 - 9 këngë, të cilat të kenë shtrirje brenda oktavës, ku çdo këngë mësohet në 2 orë dhe në disa raste në 3 orë kur është e vështirë. Këngët do të jenë të thjeshta me tematikë të larmishme nga shoqëria, familja, natyra, shkolla, popullore etj.

##### Objektivat

Në këtë linjë nxënësit të jenë në gjendje:

- ▶ të këndojnë “Himnin e flamurit”;
- ▶ të këndojnë këngë të thjeshta për fëmijë: tematike, didaktike dhe të krahinës, brenda oktavës do-do<sup>2</sup>;
- ▶ të zhvillojnë shprehitë vokale gjatë të kënduarit, si:
  - qëndrimi drejt,
  - rregullat e frymëmarrjes,
  - diksioni,
  - këndimi me ndjenjë,
  - këndimi me intonacion;
- ▶ të këndojnë solo;
- ▶ të këndojnë në grup (ansambël/kor);
- ▶ të këndojnë dhe të interpretojnë në mënyrë shprehëse;
- ▶ të shfaqin shijet e tyre dhe të shprehin mendimin rreth muzikës që këndojnë, si dhe këngëve të ndryshme (këngë për fëmijë, shqiptare ose të huaja, edhe të krahinës).

**Njohuri dhe aftësi kryesore:** ritmi, intonacioni, frymëmarrja, diksioni, interpretimi, këndimi solo, në grup, këndimi i saktë i tekstit, frymëmarrja e rregullt, intonacioni i saktë, interpretimi me ndjenjë i këngëve.

##### **LINJA II. Bazat e arsimimit muzikor**

Në këtë linjë nxënësit do të zhvillojnë ndjenjën ritmike dhe melodike të këngëve ose pjesë të ndryshme muzikore.

##### Objektivat

Në këtë linjë nxënësit të jenë në gjendje:

- ▶ të përjetojnë dhe zhvillojnë ndjenjën ritmike 2/4, 3/4, 4/4 tek këngët, lojërat, pjesët muzikore;
- ▶ të ligjërojnë modele ritmike 2/4, 3/4, 4/4;
- ▶ të krijojnë modele të thjeshta ritmike në këto kohë me rrahje shuplakash ose goditje shkopinjsh;
- ▶ të regjistrojnë gjatësi ritmike (*p.sh., modele të tingujve të gjatë dhe të shkurtër, të lartë ose të ulët etj., me grafikë*).

**Njohuri dhe aftësi kryesore:** ritmet e thjeshta 2/4, 3/4, 4/4, vetitë e tingullit, timbri, krijimi i modeleve të ndryshme në kohët e thjeshta, dallimi dhe zbatimi i vetive të tingullit në shembuj të ndryshëm, përcaktimi i timbrit të zërave apo instrumenteve.

### **LINJA III. Luajtja me instrument**

Në këtë linjë nxënësit do të mësojnë të lidhin njohuritë muzikore me luajtjen në instrument. Ata duhet të kuptojnë dhe manipulojnë gjatë luajtjes me instrument ritmet e thjeshta muzikore.

Objektivat

Në këtë linjë nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- ▶ të krijojnë ritme të ndryshme nëpërmjet instrumenteve me goditje;
- ▶ të shoqërojnë këngët ose meloditë e ndryshme me instrumente ORF.

**Njohuri dhe aftësi kryesore:** ritmet, veglat ritmike dhe ORF, luajtja e ritmeve të thjeshta, shoqërimi me instrumente ritmike dhe ORF.

### **LINJA IV. Dëgjimi muzikor**

Në këtë linjë nxënësit do të vazhdojnë të aftësohen për të dëgjuar muzikë.

Objektivat

Në këtë linjë nxënësit duhet të jenë në gjendje:

▶ të dallojnë pjesët vokale nga instrumentale duke, dalluar disa karakteristika të tyre:

- zërat e njerëzve dhe të instrumenteve të ndryshëm.

▶ të dëgjojnë pjesë të thjeshta për *piano*, *kitarë*, *violinë*, duke i përcaktuar ato përmes dëgjimit.

**Njohuri dhe aftësi kryesore:** cilësitë e zërit, timbri, dëgjimi me vëmendje i fragmenteve ose pjesëve muzikore.

### **LINJA V. Shprehje dhe krijim muzikor**

Objektivat

Në këtë linjë nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- ▶ të përjetojnë muzikën nëpërmjet arteve të tjera: vallëzim, vizatim, poezi etj.;
- ▶ të shpjegojnë me fjalë të thjeshta, ndjenjën që ata provojnë përmes përjetimit të pjesëve me karakter të ndryshëm: të *dhimbshëm*, të *gëzuar*, të *qetë*, *marsh*;
- ▶ të përcjellin mendimet dhe emocionet e tyre rreth muzikës që ata dëgjojnë;
- ▶ të listojnë disa fjali, shprehje, që ata përdorin për të shprehur marrëdhëniet e tyre me muzikën.

**Njohuri dhe aftësi kryesore:** karakteret muzikore: të dhimbshme, të gëzuara, të qeta, marshe, aftësia për t'u shprehur rreth një muzike të caktuar, me fjalë ose nëpërmjet arteve të tjera.

## 5. Shpërndarja e orëve

Në klasën e katërt të arsimit të detyruar 9-vjeçar, edukimi muzikor zhvillohet në 35 javë mësimore me 1 orë në javë. Përdoruesit e këtij programi duhet të kenë parasysh që të planifikojnë orë përsëritjeje të vazhdueshme mbi njohurive të marra.

$$35 \text{ javë} \times 1 \text{ orë} = 35 \text{ orë vjetore}$$

Linjat	Sasia e orëve
Këndimi	19 orë
Bazat e arsimit muzikor	4 orë
Dëgjim muzikor	2 orë
Luajtje në instrument	2 orë
Shprehje dhe krijim muzikor	3 orë
Orë të lira	5 orë

### Orë të lira

Qëllimi i orëve të lira (deri në 15% e sasisë totale të orëve) janë lënë për t'i krijuar hapësira të nevojshme iniciativës dhe krijimtarisë së shkollës dhe të mësuesit për të përmbushur sa më mirë nevojat dhe interesat e nxënësve në përputhje me objektivat e programit zyrtar të miratuar nga MASH.

Statusi i tyre është sa i detyrueshëm aq edhe fleksibël. Është i detyrueshëm sepse duhen zhvilluar deri në fund të vitit shkollor. Është fleksibël sepse shpërndarja përgjatë vitit dhe mbushja me material mësimor është lënë në dorë të mësuesit në bashkëpunim me drejtorinë arsimore, drejtorinë e shkollës dhe me mësuesit e tjerë të shkollës.

Për mbushjen e tyre me material mësimor mund të përdoren burime të ndryshme, por gjithmonë të bëhet kujdes të punohet për arritjen e kërkesave të programit.

Grumbullimi i fakteve, të dhënave të ndryshme kulturore, historike, gjeografike, demografike, mund të kthehen në një burim të vlefshëm për të organizuar orë mësimore interesante.

Organizimi i veprimtarive artistike apo vizitat në qendra të ndryshme kulturore muzikore janë në shërbim të një objekti të caktuar të programit; organizimi i konkurseve brenda klasës; organizimi i një koncerti, biseda, lojëra të ndryshme muzikore; përforsimi i njohurive të shoqëruar me metoda e strategji që fuqizojnë si të nxënësve ashtu edhe mësuesit, janë disa veprimtari rekomanduese për rubrikën e orëve të lira.

Për mbushjen efikase të një pjese të orëve të lira mund të bashkëpunohet edhe me mësuesit e lëndëve të tjera duke hartuar paraprakisht një plan të përbashkët disa orësh që shfrytëzon lidhjet konceptuale ndër-lëndore dhe aspektet kroskurrikulare. Nxënësve u jepet një detyrë e cila përfshin njohuri ndër-lëndore dhe u shërben arritjes së objektivave të programeve të disa lëndëve dhe objektivave kroskurrikulare.

Shpërndarja dhe varieteti i veprimtarive, duke ju gjetur vendin e duhur përgjatë vitit mësimor, është një element i rëndësishëm i zbatimit me sukses të rubrikës të orëve të lira.

Kujdes duhet bërë që orët e lira të mos shpërdorohen duke i shfrytëzuar për qëllime rutinë të cilat nuk sjellin risi të reja në kurrikulin shkollor.

## 6. Integrimi

Ky program jep mundësinë që në tema të veçanta, edukimi muzikor të integrohet edhe me lëndë të tjera meqë mësuesi është njohës i mirë i tërësisë së programit të klasës. Nxënësit mësojnë të ndërtojnë lidhjet ndërmjet muzikës dhe edukimit figurativ, leximit, edukimit fizik, matematikës, gjeografisë duke kuptuar rëndësinë e muzikës si burim kënaqësie dhe si mënyrë komunikimi brenda një kulture dhe kulturave të tjera.

**Integrimi** në linjën e këngës bëhet me: gjuhën amtare (duke interpretuar dhe bërë koment sipas tematikës që kanë këngët), edukatën qytetare (kur kënga mund të trajtojë çështje të tilla si sjellja, familja, shoqëria etj), edukimin fizik (kombinimi i lëvizjeve trupore me muzikën që ata këndojnë), diturinë e natyrës (frymëmarrja).

**Integrimi** në linjën e BAM, bëhet me matematikën (rreth thyesave, kuptimi dhe krahasimi i thyesave), edukimin figurativ (përdorimi i vijave në ndërtimin e grafikëve muzikorë).

**Integrimi** në linjën e SHKM bëhet me edukimin fizik (harmonizimi i lëvizjeve me rrahjet ritmike), (harmonizimi i lëvizjeve trupore me muzikën), me leximin (shkrimi i bukur dhe me ndjenjë i një pjese muzikore që i pëlqen), edukimi figurativ (përdorimi i ngjyrave, vijave, formave për të përcjellë një mendim).

**Aspektet kros-kurrikulare** janë patur parasysh në shtjellimin e rubrikave të programit. Gjatë zbatimit të tij një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet:

- çështjeve të mjedisit, ndotjes dhe mbrojtjes së tij;
- kulturës së komunikimit (aftësimi të nxënësve për të kuptuar dhe zbatuar informacionin e shkruar në jetën e përditshme;
- mjeteve të informimit si media dhe masmedia, internetit;
- përdorimit të teknologjive të informacionit, mjeteve audio-vizive, kompjuterit;
- përdorimit të gjuhës së huaj;
- edukimit për të drejtat e njeriut;
- çështjeve të barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore, fetare;
- atdhedashurisë (informacion kulturor - artistik, ekonomik, social, historik, gjeografik);
- globalizmit.

## 7. Metodologjia e zbatimit të programit

Një vend shumë të rëndësishëm në këtë program ka formulimi i objektivave, si dhe përcaktimi i metodave që do të përdorin përdoruesit e këtij programi, për të qenë sa më të suksesshëm. Përzgjedhja e metodave mësimore bëhen, në përputhje me veçoritë e moshës së nxënësve, të përmbajtjes së temave të ndryshme mësimore apo të bazës

materiale mësimore që ka në përdorim. E rëndësishme është që përdoruesit të krijojnë një mjedis mësimi, i cili do t'i nxisë dhe do t'i ndihmojë nxënësit për të zbuluar dhe për të zhvilluar aftësitë dhe prirjet e tyre muzikore. Gjithashtu, përdoruesit e këtij programi duhet të organizojnë veprimtari të larmishme praktike sa të jetë e mundshme, pasi shumë aftësi të përcaktuara në program duhet të arrihen nëpërmjet pjesëmarrjes në to.

Ky program mundëson zhvillimin e modeleve të ndryshme ritmike apo melodike, dhe i drejton nxënësit në përjetimin e kohës 2/4, 3/4, 4/4, përmes veprimtarive konkrete, zhvillimit të lojërave individuale dhe në grup. Nën drejtimin e përdoruesve të këtij programi, nxënësit në këtë nivel rikujtojnë dhe përvetësojnë më tej njohuri dhe elemente të reja muzikore, duke zhvilluar kështu aftësitë për të kënduar, për të dëgjuar apo për t'u shprehur, si dhe për të bërë një analizë të thjeshtë të këngëve apo të pjesëve muzikore. Niveli i dijeve e shprehive të nxënësit përcaktohet jo vetëm nga përmbajtja e lëndës, por edhe nga zbatimi i udhëzimeve e kërkesave të veçanta që ka çdo klasë. Edhe në këtë klasë mësohen këngë në përshtatje me moshën për nga shtrirja (ambitusi) do-do dhe nga përmbajtja, me vlera didaktike, të karakterit femënor (natyrën, familjen, shkollën, punën, argëtimin etj.) me ritme të larmishme (vallëzuese, marshe, të thjeshta, të përziera) dhe të krahinës. Nuk duhet harruar që pas përvetësimit të disa këngëve mund të bëhet një përsëritje e tyre.

Këngët zgjidhen në përshtatje me kërkesat e bazave të arsimimit muzikor për edukimin e ndjenjës ritmike dhe melodike. Çdo orë këndimi realizon kërkesa të bazave të arsimimit muzikor. Prandaj këndimi dhe bazat e arsimimit muzikor zhvillohen duke u ndërthurur njëri me tjetrën gjatë orës mësimore. Lënda e edukimit muzikor duhet të përqendrohet te:

**1. Edukimi i ndjenjës ritmike të nxënësve.** Dukuritë ritmike përjetojnë në formë konkrete dhe më pas arrihet zbatimi i tyre praktik. Përdoruesit duhet t'u kujtojnë dukuritë nga natyra dhe mjedisi, duhet të sjellin në klasë modele të thjeshta ritmike (2/4, 3/4, 4/4) duke i zhvilluar ato me nxënësit. Gërshetimi i ushtrimeve me ritmet e thjeshta në shoqërimin e këngëve është më se i këshillueshëm.

**2. Edukimi i ndjenjës melodike.** Përdoruesit duhet të zhvillojnë ndjenjën melodike përmes të kënduarit të këngëve, shembujve shumë të thjeshtë melodikë, ose përmes dëgjimit muzikor.

**3. Edukimi i shprehive të kënduarit** shikohet i pandarë nga aftësitë dhe shprehitë e tjera në edukimin muzikor. Përdoruesit punojnë për të zhvilluar shprehitë e të kënduarit gjatë gjithë vitit:

- rikujtimi i kërkesave gjatë të kënduarit,
- zhvillimi i ndjenjës ritmike saktë,
- intonimi i saktë.

**4. Edukimi me instrumentet dhe marrëdhëniet me to.** E dhe në këtë aspekt vazhdon më tej puna me instrumentet me goditje dhe ORF dhe instrumentet konkretë të sjella në program. Këto instrumente krijojnë lidhje të afërta me artin muzikor dhe zhvillojnë njëkohësisht ndjenjën ritmike të nxënësve. Instrumenti shton interesin për lëndën, si dhe i ndihmon nxënësit drejt edukimit të ndjenjës ritmike dhe melodike.

**5. Edukimi për zhvillimin e shprehive gjatë dëgjimit.** Dëgjimi i këngëve ose pjesëve të thjeshta muzikore zhvillon njohuritë e nxënësve jo vetëm në drejtim të muzikës, por edhe në drejtim të kulturës në tërësi, duke i edukuar ata me dëshirën për të

dëgjuar. Dëgjimi është mënyra kryesore nëpërmjet të cilit nxënësit vihen në marrëdhënie me muzikën. Nga njohuritë që ata kanë tashmë rreth ritmit, tingujve, kohëve të thjeshta 2/4, 3/4, 4/4, karakterit, ata përjetojnë emocionet që sjell pjesa apo kënga, duke bërë vlerësimin e saj me fjalë të thjeshta. Përdoruesit e këtij programi vazhdojnë punën për kultivimin e ndjenjës së të dëgjuarit të nxënësit, duke përdorur gjithashtu formën e bisedës, ku sqarohen dhe shpjegohen karakteri i pjesës, elementet muzikore, si: vetitë e tingullit, ritmin, karakterin etj.; rinjohja e instrumente muzikore përmes dëgjimit duke dalluar timbrin e tyre etj. Gjithashtu është e domosdoshme që përdoruesit e këtij programi duhet të kultivojnë te nxënësit ndjenjën kritike dhe vlerësuese kështu ata mësohen të mbajnë qëndrim, duke përdorur një fjalor të thjeshtë muzikor.

### **8. Vlerësimi**

Vlerësimi është një proces, i cili jep një informacion të domosdoshëm e të mjaftueshëm për të verifikuar e për të matur përvetësimin e njohurive dhe të shprehive nga nxënësit.

Vlerësimi në klasën e katërt bëhet me notë. Vlerësimi i nxënësve në këtë lëndë të bëhet përmes përfundimeve që arrin nxënësi çdo ditë gjatë procesit mësimor, vetëm ose në grup nga veprimtaria praktike, d.m.th. përmes të kënduarit, të luajturit, të dëgjuarit, të analizuarit të pjesëve muzikore etj. Vlerësimi bëhet në atë ç'ka nxënësi ka përvetësuar dhe është i aftë të bëjë.

Gjithashtu, mësuesi do të ketë si udhëzues edhe dokumentin e standardeve të arritjes për këtë lëndë.